



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Administratës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. *13/G13-24* Prot.  
Nr. Dok. 202101362/24

Tiranë 03/06/2022

**Lënda:** *Rekomandim lidhur me shkeljen e të drejtave të shtetasve të prekur nga projekti për zhvillimin e zonës "5 Maji" dhe marrjen e masave për nxjerrjen e përgjegjësive dhe evidentimin e personave përgjegjës për shkeljet dhe mospërsëritjen e tyre në vijim.*

INSPEKTORIATIT TË MBROJTJES SË TERRITORIT

TIRANË

BASHKISË

TIRANË

Për dijeni:

KOMISIONI PËR ÇËSHTJET LIGJORE ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË  
DREJTAT E NJERIUT

TIRANË

INSPEKTORIATIT KOMBËTAR TË MBROJTJES SË TERRITORIT

TIRANË

Të nderuar,

Sikurse jeni në dijeni, Institucioni i Avokatit të Popullit (në vijim AP), në ushtrim të kompetencave kushtetuese e ligjore për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve shqiptarë dhe të huaj që jetojnë në territorin e RSH, ka marrë në administrim disa ankesa të banorëve të Njësisë Administrative Nr. 4 dhe 8 Tiranë.

Këta të fundit, pretendojnë shkeljen e së drejtës së tyre të pronësisë e realizuar me anë të vendimit nr.533, datë 22.09.2021, “Për shpronësimin për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit për zhvillimin e zonës së re, në përputhje me planin e detyruar vendor, përmes kompesimit me shkëmbim për të gjitha pasuritë që preken nga realizimi i projektit “Për zonën e re për zhvillim në njësinë administrative nr.4 dhe 8, zona “5 Maj”, Bashkia Tiranë”. Nëpërmjet këtij ankimi banorët pretendojnë se janë vënë në dijeni nga IMT Bashkia Tiranë, për lirim të objekteve por nuk kanë asnjë informacion lidhur me strehimin e tyre. Banorët kanë pretenduar se nuk kanë patur dijeni të plotë në lidhje me procesin e shembjes së banesave të tyre nga ana e Bashkisë Tiranë dhe strukturave të vartësisë së saj, nuk janë bërë me dije mbi procedurat që do të ndiqen për garantimin e strehimit pas prishjes së godinave të tyre. Gjithashtu këta banorë pretendojnë se nuk kanë patur kohën e mjaftueshme për nxjerrjen e sendeve të luajtshme nga banesat e tyre, për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm si dhe kohën e mjaftueshme për të ushtruar të drejtën e ankimit. Avokati i Popullit ka ndarë hetimin administrativ në dy grupe kërkesash, njëra që lidhet me veprimtarinë e IMT-së dhe tjetra lidhet me çështje të thelbit të procedurës së ndjekur në kuadër të Aktit Normativ nr.9/2019.

#### ➤ **Parashtrimi i fakteve dhe rrethanave**

Pas tërmetit tragjik të 26 Nëntorit 2019, Këshilli i Ministrave (në vijim KM) me propozim të Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë, vendosi të miratonte Aktin Normativ Nr.9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, akt i cili me ligjin nr.97, datë 18.12.2019, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë duke marrë fuqinë e ligjit.

Nëse i referohemi përmbajtjes së këtij akti, konstatohet se ai u iniciua me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore që ndodhin në një pjesë apo të gjithë territorin e RSH, si dhe të fatkeqësive të tjera të cilat kërkojnë ndërhyrjen e menjëhershme të të gjitha institucioneve të mbrojtjes civile.

Ky akt rregullon funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera. Një fushë tjetër përgjegjësie që parashikohet në këtë akt rezulton të jetë edhe zhvillimi i territoreve të reja, sikurse edhe në rastin objekt shqyrtimi administrativ. Gjithsesi këto territore duhet të zhvillohen përputhje me qëllimin thelbësor të ligjit që është adresimi i fatkeqësive natyrore. Në zbatim të këtij akti, tashmë me fuqinë e ligjit, u miratua VKM nr.887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit në rastet e fatkeqësisë natyrore”. Ky vendim ka për objekt dhe qëllim kryesor të tij, përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor si dhe procedurën e miratimit të lejeve të zhvillimit dhe lejeve të ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore, si dhe për zonat e reja për zhvillim. Në zbatim të tij u miratua Plani i Detyruar Vendor për të cilin jemi në dijeni, ndërsa përsa i përket procedurave dhe miratimit të lejeve të zhvillimit dhe atyre të ndërtimit nuk kemi informacion pasi nuk na janë vënë në dispozicion nga Bashkia Tiranë dhe drejtoritë e vartësisë të saj, ku përfshihet edhe IMT. Në vijim, në zbatim të aktit normativ u miratuan edhe dy VKM të tjera e përkatësisht VKM nr.7/2020 “Për kushtet dhe procedurën për shpronësimet dhe/ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit”. Në pikën 2 të këtij vendimi përcaktohet:

*“Në funksion të procesit të rindërtimit, pronarët e trojeve dhe të banesave që përfshihen në zonat e planifikuara për ndërtim ose në zonat e reja për zhvillim, subjekte private, mund të shpronësohen, për interes publik, duke u kompensuar në vlerë ose nëpërmjet shkëmbimit të pasurisë private me një pasuri tjetër të paluajtshme, në pronësi të shtetit, aktuale ose të ardhshme ose nëpërmjet kombinimit të kompensimit në vlerë me shkëmbimin e pronës private me një pasuri shtetërore aktuale ose të ardhshme, në përputhje me parashikimet e aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, si dhe procedurën e parashikuar në këtë vendim”, e cila ligjëron ndërmarrjen e kësaj iniciative për*

shpronësimin e banorëve të zonës së “5 Majit” në funksion të të ashtëquajturit interes publik.

Ky vendim u ndryshua me vendimin nr.170, datë 17.03.2021, i cili solli ndryshime lidhur me trajtimin e pronave private njësi tregtimi, të cilat tashmë do të trajtohen në mënyrë të barabartë me objektet e tjera të shpronësuara për interes publik. Në të njëjtën kohë u miratua edhe VKM nr.8/2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”. Në pikën 1 të tij ky vendim parashikon: “Ndërtimet pa leje, në zonat e planifikuara për ndërtim ose në zonat e reja për zhvillim, përjashtohen nga procedurat e legalizimit, të parashikuara në legjislacionin në fuqi për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje. Poseduesit e tyre përfitojnë sipërfaqe ndërtimore në objektet e reja që do të ngrihen në këto zona, sipas kushteve dhe kriterëve të këtij vendimi”.

Më tej, në funksion të aktit normativ nr.9/2019, u miratua VKM nr. 5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”. Me këtë akt parashikohen rregullat për përfitimin nga programi i granteve të rindërtimit, nëpërmjet miratimit të projekteve model, masën e përfitimit të granteve të rindërtimit të shtëpive individuale të banimit ose të rikonstruksionit të banesave, ndërtesave ose shtëpive individuale të banimit, kushtet, kriteret, procedurat dhe autoritetet përgjegjëse për shpërndarjen e granteve dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave përkatëse, sipas parashikimeve të nenit 25, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”. Ndërsa në vijim, me VKM-në Nr. 78, datë 31.1.2020 “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësitë administrative 4 dhe 8, zona “5 maji”, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese”, kjo zonë u shpall si zonë në zhvillim dhe Bashkia Tiranë, u caktua si njësi zbatuese për ndërtimin e banesave të reja, ndërtesave publike të dëmtuara, rikonstruksionin, realizimin e ndërtimeve në këtë zonë, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të kësaj zone. Ndërkohë, në zbatim të nenit 32 të aktit normativ nr.9/2019, i cili parashikon: “Në funksion të procesit të rindërtimit, sipas parashikimeve të këtij akti, mund të zbatohen procedurat e parashikuara për shpronësimin për interes publik, sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi për shpronësimin për interes publik ose shkëmbimi i pasurisë së paluajtshme të palës private me një pasuri tjetër

të paluajtshme në pronësi të shtetit”, u miratua VKM-në Nr. 533, datë 22.9.2021, “Për shpronësimin për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit për zhvillimin e zonës së re, në përputhje me planin e detyruar vendor, përmes kompensimit me shkëmbim, për të gjitha pasuritë që preken nga realizimi i projektit “për zonën e re për zhvillim në njësitë administrative 4 dhe 8, zona ‘5 Maji’, Bashkia Tiranë”. Ky vendim, si akti konkret i shpronësimit të objekteve për interes publik, paraqet tabelën përkatëse ku listohen subjektet që do të shpronësohen nga pasuritë e tyre për zhvillimin e zones së re si dhe thekson përsëri faktin se shpronësimi përmes kompensimit me shkëmbim bëhet në favor të Bashkisë Tiranë, me qëllim rindërtimin e zonës, pra Bashkia është edhe njësia përfituese nga kjo veprimtari. Ndërkohë, me Vendimin nr. 129 datë 15.10.2021 “Për miratimin e draft akt-marrëveshjes paraprake për premtim shkëmbimi të pasurisë aktuale me pasurinë e ardhshme që do të lidhet ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe përfituesve pasuritë e të cilëve shpronësohen për interes publik në funksion të procesit të rindërtimit” të Këshillit Bashkiak Tiranë, u miratua modeli i Akt-Marrëveshjes paraprake për premtim shkëmbimin e pasurisë aktuale me pasuri të ardhshme, hartuar sipas përcaktimit të pikës 4 të VKM-së, nr. 533 datë 22.09.2021. Nga përmbajtja e kësaj akt-marrëveshje paraprakisht konstatohet se ka disa parregullsi të cilat çojnë në shkeljen e një sërë të drejtash dhe parimesh të rëndësishme të së drejtës së pronësisë. Trajtimi lidhur me elementët, formën dhe vlefshmërinë e kësaj akt-marrëveshje janë objekt i një hetimi tjetër administrativ nga institucioni ynë, për të cilin do të shprehet në një rekomandim tjetër. Nga kuadri ligjor dhe nënligjor nuk parashikohet në mënyrë specifike veprimtaria e IMT. Gjithë sa u parashtrua më lart është një përmbledhje e asaj sesi u iniciua ky proces dhe kuadrin përkatës ligjor e nënligjor për çdo rast, por më poshtë do të trajtojmë veprimtarinë konkrete dhe mënyrën e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore të sipërcituara nga IMT pranë Bashkisë Tiranë, e konstatuar nga hetimi administrativ i zhvilluar nga Avokati i Popullit. Evidentojmë faktin se ky hetim u iniciua referuar publikimeve përmes mediave të shkruara dhe atyre audio-vizive, si dhe referuar ankesave të shtetasve/banorëve të prekur nga ky proces. Avokati i Popullit pasi u njoh me përmbajtjen e këtyre publikimeve, objektin e ankesave të banorëve dhe referuar dokumentacionit të depozituar prej tyre, vendosi marrjen në shqyrtim dhe çeljen e hetimit administrativ lidhur me këtë problematikë. Kjo referuar përcaktimeve të nenit 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 8485, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” të ndryshuar: “Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën

*e vet, për raste të veçanta të bëra publike*". Për zhvillimin e një hetimi administrativ të plotë e të gjithanshëm, i cili do të konkludojë në sqarimin e plotë të fakteve dhe rrethanave dhe arritjen e një vlerësimi objektiv, ju drejtuam me kërkesa për shpjegime IMT-së dhe drejtorive përkatëse përgjegjëse për këtë procedurë administrative.

E gjithë kjo veprimtari u krye në zbatim të detyrimit tonë kushtetues e ligjor, referuar përcaktimeve të nenit 63, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet:

*"Organet dhe funksionarët publik janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij"*, si dhe parashikimit të kryer në nenin 19, pika "b", të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, ku përcaktohet: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin"*. Në referim të këtij detyrimi si dhe në funksion të hetimit administrativ, u adresuan kërkesat tona, si më poshtë:

1. Shkresë nr.K3/GJ13-4 prot., date 02.11.2021 "Kërkesë për shpjegime", drejtuar IMT-së, me të cilën është kërkuar të na vihet në dispozicion gjithë procedura e ndjekur në këtë proces, si dhe çdo dokumentacion që i ka shërbyer atij.
2. Me Shkresën nr.K3/GJ13-9 prot., date 18.11.2021 "Kërkesë e përsëritur për shpjegime", drejtuar Bashkisë Tiranë, është rikërkuar të na vihet në dispozicion gjithë procedura e ndjekur nga IMT në këtë proces, pasi nuk është kthyer përgjigje.

Në përgjigje të kërkesve tona dhe pas insistimit të përsëritur, me shkresën nr.41897/1 prot., datë 07.12.2021, "Për kompetencë", bëhemi me dije se IMT i ka kaluar Drejtorisë së Përgjithshme të Aseteve dhe Liçencimit, çështjen për kompetencë. Ndësa me shkresën nr.43779/1 prot., datë 11.11.2021 "Kthim përgjigje", IMT na bën me dije kompetencën e tij, ligjin e aktet nënligjore ku është mbështetur veprimtaria në këtë rast, si dhe sqaron se me shkresën nr.39032/1 prot., datë 07.10.2021 "Kërkesë për bashkëpunim", me të cilën rezulton se është kërkuar bashkëpunimi për lirim të sheshit të ndërtimit, nga Drejtoria e Investimeve të Punëve Publike pranë Bashkisë Tiranë. Me këtë shkresë ky organ shprehet më tej se u ka dorëzuar njoftimet qytetarëve për datën e prishjes së objekteve. Ndërsa përsa i përket radhës së prishjes së këtyre objekteve shprehet se janë bazuar në shkresën e sipërcituar të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike. Bashkëlidhur shkresës na janë vënë në dispozicion vetëm njoftimet drejtuar qytetarëve pa dokumentacion provues shtesë në lidhje me komunikimin e këtyre vendimeve, konkretisht

nuk na janë vënë në dispozicion, si p.sh akte konstatimi, procesverbale, apo dokumentacion që ka provuar faktin e marrjes dijeni nga banorët etj. Referuar dokumentacionit shoqërues, konstatohet se u janë drejtuar njoftime 107 qytetarëve, në data të ndryshme.

Ndërkohë konstatohet se disa prej njoftimeve janë dërguar para se të miratohet vendimi i Këshillit **Bashkiak** për akordimin e bonusit të qirasë për strehimin e banorëve të prekur nga ky projekt. Në vijim të këtij konstatimi, evidentojmë se vendimi për miratimin e bonusit të qirasë për banorët e prekur nga ky projekt, i përket datës 15.10.2021, ndërsa njoftimet janë dërguar/hartuar në këto data, si më poshtë:

- Në datë 05.10.2021 janë hartuar 2 njoftime;
- Në datë 07.10.2021 janë hartuar 9 njoftime;
- Në datë 11.10.2021 janë hartuar 9 njoftime;
- Në datë 14.10.2021 janë hartuar 2 njoftime;
- Në datë 19.10.2021 janë hartuar 29 njoftime;
- Në datë 25.10.2021 janë hartuar 27 njoftime;
- Në datë 29.10.2021 janë hartuar 29 njoftime.

Ndërsa prishjet e para kanë filluar dhe janë realizuar nga IMT që në datë 14.10.2021 e në vijim sikundër provohet nga përmbajtja e shkresave nr. 1253 prot datë 03.02.2022 dhe nr. 2062 prot datë 03.03.2022.

Duke mos e konsideruar shteruese në lidhje me të gjitha kërkimet tona shkresën e mësipërme, me shkresën nr.K3/GJ13-7 prot., date 14.02.2022 “Kërkesë përsëritur për shpjegime”, kemi rikërkuar informacionin/dokumentacionin e pakthyer si dhe informacion shtesë, si më poshtë:

- Në kushtet kur me shkresën tuaj nr.43779/1 prot., datë 11.11.2021 “Kthim përgjigje”, nuk ka dokumentacion shoqërues, për të provuar marrjen e njoftimit nga secili prej subjekteve të shpronësuar, si provohet që ata efektivisht janë njohur me vendimin e prishjes si dhe që janë njoftuar brenda afateve të nevojshme për marrjen e masave të duhura?
- A ka marrë institucioni juaj vendime për prishjen e secilit prej objekteve në mënyrë të veçantë? Po veprime të tjera administrative në funksion të këtij procedimi, si

akte konstatimi, procesverbale etj., a janë kryer ne zbatim te ligjit Ligji Nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”? Nëse po të na vihen në dispozicion dhe nëse jo të na sqaroni lidhur me mungesën e tyre.

- A është verifikuar nga ana juaj lidhja e kontratës paraprake mes Bashkisë Tiranë dhe subjekteve të shpronësuar?
- Në momentin e zbatimit të vendimit për prishjen e objekteve a janë verifikuar nga ana juaj përfitimi i bonusit të qirasë me qëllim që banorët të mund të kishin pasur kohën e duhur efektive për marrjen e masave për lirimin vullnetar të banesave.
- Si është vepruar dhe zbatuar nga ana juaj në bashkërendim me pushtetin e qeverisjes vendore, Bashkinë Tiranë në këtë rast, lirimi i sheshit të ndërtimit nga objektet që do të preken nga zbatimi i VKM-së nr.533, datë 22.09.2021? Sa kohë u është lënë familjeve nga momenti i njoftimit të vendimit për prishjen e objektit për lirimin vullnetar të tyre dhe a kishin përfituar ata bonusin e qirasë në momentin e prishjes së objektit nga ana juaj?
- A është bërë një verifikim paraprak nga ana juaj në lidhje realizimin e projektit “Për zonën e re për zhvillim në njësinë administrative nr.4 dhe 8, zona “5 Maj”, Bashkia Tiranë”, për të cilën ka dalë VKM-ja nr.533, datë 22.09.2021 “Mbi zbatimin e ligjit nr. 107/2014 ne harmoni me ligjin nr Ligji Nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”? A ka pasur një verifikim nga ana juaj lidhur me faktin nëse subjekti i shpronësuar dhe institucionet përkatëse kanë përfunduar të gjithë procesin e nevojshëm për realizimin e kësaj procedure?
- Të na vihet në dispozicion gjithë praktika e dërguar nga Bashkia Tiranë (drejtoritë përkatëse) për lirimin e sheshit të ndërtimit si dhe korespondenca përkatëse.

Për secilën prej kërtimeve të parashtruara është kërkuar të na vihet në dispozicion edhe çdo dokumentacion tjetër që vërteton qëndrimet tuaja dhe provon veprimtarinë e rregullt ligjore të institucionit tuaj. Në përgjigje të shkresës tonë, IMT na ka thyer përgjigje me shkresën e saj nr.1713/1 prot., datë 22.02.2022 “Kthim përgjigje”. Me këtë shkresë IMT ndër të tjera i është përgjigjur pyetjes së shtruar nga ana jonë se ku është bazuar për ndërhyrjen dhe prishjen e objekteve në këtë zonë. Nga kjo përgjigje rezulton se IMT e justifikon këtë veprimtari vetëm me shkresën nr.43779/1 prot., datë 07.10.2021, të Drejtorisë së Investimeve të Punëve Publike pranë Bashkisë Tiranë, me anë të së cilës kërkohet bashkëpunimi i IMT-së për lirimin e sheshit të ndërtimit në këtë zonë. Ndërsa

përsa i përket pyetjes se si provohet se qytetarët janë njoftuar rregullisht dhe në përputhje me dispozitat procedurale ligjore, shprehet se njoftimet janë kryer personalisht nga specialistët e bashkisë dhe momenti i dorëzimit është shoqëruar me foto.

Gjithashtu ky organ pretendon se është bërë edhe afishimi publik në njësinë përkatëse administrative, duke e pretenduar këtë si mënyrë të zakonshme njoftimi. Ndërkohë, përsa i përket pyetjes së AP nëse janë marrë vendime prishje për objektet në mënyrë nominale, ky organ shprehet se nuk janë marrë vendime për prishjen e objekteve në mënyrë nominale pasi për këtë i janë referuar pikës 2 të VKM-së nr.533, datë 22.09.2021, pa dhënë më tej sqarime të tjera.

Ndodhur në kushtet kur Bashka Tiranë dhe drejtoritë në varësi të saj nuk i ishin përgjigjur në mënyrë shteruese shkresave dhe pyetjeve të bëra nga AP, ky i fundit kërkoi dhe realizoi një takim me zv. Kryetarin e Bashkisë Tiranë të cilëve ju parashtruan nga ana e Avokates se Popullit znj. Erinda Ballanca gjithë problematika e konstatuar gjatë këtij hetimi administrativ dhe në veçanti mosdhënia e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar nga AP në kuadër të këtij hetimi administrativ.

Në vijim të këtij takimi, nga AP u ridërgua nëpërmjet kumunikimit elektronik të dates 13.04.2022, një përmbledhje e gjithë kërkesave, korrespondencës së kryer midis AP dhe Bashkisë Tiranë duke evidentuar në mënyrë të hollësishme kthim përgjigjet e kësaj të fundit për çdo kërkesë të dërguar nga AP.

Në 20.05.2022 nga ana e Bashkisë Tiranë nëpërmjet komunikimit elektronik, ka dërguar përgjigje për sa ishte kërkuar së bashku me dokumentacionin shoqërues.

Nga dokumentacioni i paraqitur në rrugë elektronike rezulton se në pjesën më të madhe të tij ai është përsëritje e atij të dërguar më parë nga Bashkia Tiranë dhe IMT, duke mos rezultuar fakte apo prova të reja, përveç shkresave nr.3620/1 prot., datë 09.11.2021 nga Njësia Administrative nr.4, shkresë datë nr.3672/1 prot., 15.11.2021 e njësisë Administrative nr.4 dhe shkresë nr.3388/1 prot., datë 12.11.2021 Njësia Administrative nr.8, plus fotografi të realizuara nga punonjësit e IMT.

Gjithashtu IMT ka dërguar informacion të përditësuar deri në datë 03.03.2022 në lidhje me ekzekutimin e prishjes së banesave, respektivisht me shkresën nr.1253 prot., datë 03.02.2022 dhe shkresë nr.2280 prot., datë 03.03.2022, nga ku rezulton se deri në datën 01.03.2022 janë ekzekutuar nga prej saj 88 objekte.

Ndërsa nga përmbajtja e shkresës nr.14934/1 prot., datë 16.05.2022 “Kthim përgjigje”, nga Drejtoria e Pasurive të Paluajtshme pranë Bashkisë Tiranë, referuar tabelës me listën emërore të pronarëve që shpronësohen me shkëmbim në funksion të rindërtimit, në këtë zonë, rezulton se janë 58 subjekte të cilët përfitojnë sipërfaqe ndërtimore për banim nga shpronësimi me shkëmbim, 12 subjekte të cilët përfitojnë sipërfaqe ndërtimore me

funksion social-ekonomik dhe 51 subjekte, posedues të objekteve në proces legalizimi, të cilët përfitojnë sipërfaqe ndërtimore për banim nga shpronësimi me shkëmbim. Ndërsa përsa i përket pyetjes tonë se sa është numri total i objekteve të parashikuara për rindërtim në zonat e shpalluara për zhvillim dhe sesa janë personat në total që do të përfitojnë, ky institucion nuk ka dhënë përgjigje.

Gjithashtu, Avokati i Popullit znj. Erinda Ballanca në lidhje me hetimin administrativ mbi këtë çështje ka marrë pjesë dhe ka dhënë shpjegime të hollësishme në seancën e posaçme të mbajtur nga Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për këtë problematikë.

### ➤ **Analizimi ligjor i fakteve dhe rrethanave**

Institucioni i AP, gjatë procesit të hetimit administrativ ka konstatuar shkelje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të banorëve të prekur nga ky projekt, nëpërmjet një procesi i cili nuk ka qenë i rregullt ligjërisht si dhe evidentohet mungesë bashkëpunimi nga IMT, në lidhje me hetimin administrativ të kryer prej tij. Ky konstatim do të parashtrohet më poshtë në analizimin e fakteve, rrethanave e provave si vijon:

**Së pari.** Evidentojmë me shqetësim të vazhdueshëm faktin se organet kompetente nuk janë bashkëpunuese përgjithësisht dhe veçanërisht në rastin konkret, gjatë procesit administrativ të zhvilluar nga AP për sqarimin e pretendimit të banorëve të prekur nga ky projekt. Kjo e parë në faktin që në çdo shkresë drejtuar institucionit tuaj, është lënë një afat prej 10 ditësh për kthim përgjigje, por nuk janë kthyer përgjigjet brenda këtij afati<sup>1</sup>. Me moskthim përgjigje kuptohet apo njësohet edhe fakti që përgjigjet nuk janë ezauruese në përmbajtjen e tyre. Me shqetësim konstatojmë se këto afate ligjore nuk janë respektuar, madje jemi detyruar të dërgojmë kërkesa të përsëritura për marrjen e një përgjigje. Përkatësisht shkresa e parë i është dërguar bashkisë me datë 25.10.2021, drejtuar Bashkisë Tiranë si organ epror dhe më pas është vijuar me shkresat e datës 02.11.2021 dhe 14.02.2022. Ndërkohë përgjigja dhe përgjigja e fundit me të cilën është përfunduar hetimi administrativ, është marrë me datë 22.02.2022. Sikurse u parashtrua, përgjigjet përveçse kur nuk kthehen brenda afateve të përcaktuara, konsiderohen të tilla edhe kur nuk janë ezauruese në përgjigjet e tyre, pasi rezultati është i njëjtë, pra sjellin zvarritjen e procesit administrativ.

---

<sup>1</sup> Në referim të përcaktimeve ligjore e konkretisht të nenit 19 të Ligjit Nr.8454 , date 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet: “Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme”,

Nuk kemi përgjigje lidhur me disa nga problematikat më serioze lidhur me fatin e këtyre banorë, masat e marra për strehimin e tyre, pra është bërë një verifikim paraprak për këtë, a është verifikuar nga ana e institucionit tuaj nëse për banorët ka qenë e mjaftueshme koha për transferim në një banesë tjetër dhe marrjen e të gjitha sendeve të luajshme nga banesa objekt shembje. Gjatë hetimit administrativ të kësaj çështje, rezulton se IMT pranë Bashkisë Tiranë, ka shkelur dhe cënuar një ndër parimet më të rëndësishme, të parashikuar në K.Pr.Administrative, parimin e bashkëpunimit ndërmjet organeve të administratës publike.

Ky fakt në gjykimin e Avokatit të Popullit është një element shumë i rëndësishëm pasi institucioni ynë, në mungesë të këtij informacioni dhe dokumentacioni pengohet të ushtrojë misionin e ngarkuar nga kushtetuta dhe ligji. Nga kjo qasje, pamundësohet vlerësimi tërësor i veprimtarisë së organeve të administratës publike, në zbatimin e një procesi të rregullt ligjor gjatë procesit të vendimarrjes lidhur me shpronësimin pasurive objekt shqyrtimi administrativ dhe strehimin e banorëve të prekur nga kjo procedurë.

Mosdhënia e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, përbën shkelje të parimeve kushtetuese dhe ligjore. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 63 të saj e ka ngritur në nivel kushtetues detyrimin e organeve të administratës shtetërore dhe funksionarëve publikë, për bashkëpunim me institucionin e Avokatit të Popullit dhe të dretjën e këtij të fundit për të kërkuar informacion e dokumentacion<sup>2</sup>. Në funksion të përmbushjes së këtij detyrimi nga institucionet përgjegjëse, edhe ligji nr.8454/1999 “Për Avokatin e Popullit”, parashikon të drejtën e institucionit tonë për marrjen e masave administrative në rast të refuzimit për bashkëpunim nga organet e administratës publike apo nëpunësit e tyre.

Madje ky ligj shkon edhe më tej duke parashikuar deri edhe propozimin apo rekomandimin drejtuar prokurorisë, për fillimin e procedimit penal, në rast të konstatimit të elementëve të veprës penale nga nëpunësit e administratës publike<sup>3</sup>.

---

<sup>2</sup> Neni 63 përcakton se: “Avokati i Popullit paraqet raport vjetor përpara Kuvendit. 2. Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t’i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme. 3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike. 4. Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”.

<sup>3</sup> Neni 21/ç i ligjit përcakton se Avokati i Popullit, mund të kryejë këto veprime: ç) “i rekomandon prokurorisë të fillojë hetime në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një vepre penale; ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara”. Ndërsa neni 22 i këtij ligji përcakton se: “Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”.

Duhet theksuar se Avokati i Popullit (AP) si institucion kushtetues, ka rol “kontrollues” mbi veprimtarinë e organeve të administratës publike në lidhje me zbatimin e respektimin e të drejtave kushtetuese, duke ndihmuar individët që t’u krijohen shanse të barabarta, të mund të trajtohen si të barabartë në çdo marrëdhënie me administratën publike, përveç gjykatave. Mungesa e bashkëpunimit duket se bëhet me qëllim shmangien e kontrollit nga institucioni kontrollues (AP) dhe lind dyshimi se ky insitucion ka kryer veprimtari të parregullt e të paligjshme gjatë procesit të tij administrativ, të cilat refuzon të bëhen të ditura kundrejt institucionit kontrollues. Në rastet kur ka pretendime nga individët për veprimtari të paligjshme apo të parregullta të organeve të administratës publike, barra e provës bie mbi këto organe të provojnë të kundërtën e pretendimeve, me anë të dokumentacionit dhe informacionit provues<sup>4</sup>.

Gjithashtu, duhet theksuar se bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies<sup>5</sup>.

Kjo qasje dhe sjellje që detyron AP të bëjë kërkesa të përsëritura për të marrë informacionin e duhur ndikon negativisht në besimin e publikut tek institucioni i Avokatit të Popullit dhe pamundëson veprimin e tij proaktiv për të parandaluar shkeljet e të drejtave të njeriut në kohë. Qëllimi thelbësor i administratës shtetërore është të parandalojë, dhe/ose të adresojë shkelje të të drejtave të njeriut në kohë e të mos lejojë përsëritjen e të tilla shkeljeve në vijim apo në të ardhmen. Për sa më sipër, qasja e institucioneve të administratës shtetërore duhet të ndryshojë thelbësisht duke vënë në qendër të interesit publik, kujdesin për të drejtat e njeriut.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit vlerëson referencën në aktin normativ përketes të parimit të rëndësishëm të rindërtimit, si parimi i përmirësimit të kushteve të jetesës dhe shëndetit, i zhvillimit të qëndrueshëm, i strehimit të përshtatshëm, i trajtimit të barabartë të shtetasve, i informimit dhe transparencës i kontrollit dhe përgjegjshmërisë në

---

<sup>4</sup> Duhet theksuar fakti se legjislatori ka paraparë si veçori themelore të institucionit të Avokatit të Popullit, veç pavarësisë nga institucionet e tjera dhe nga çdo ndikim politik, lehtësinë e kontaktimit, shpejtësinë dhe fleksibilitetin në kapjen e problemeve, si dhe mungesa e shpenzimeve, pasi veprimtaria e tij është pa pagesë. Mungesa e informacionit dhe dokumentacionit, si dhe dërgimi i përgjigjeve të pjesshme apo tej afatit të përcaktuar dhe atij të arsyeshëm ligjor, sjell zvarritjen e procesit administrativ dhe mohimin e të drejtës së qytetarëve për të gëzuar efektivisht të drejtat e tyre kushtetuese dhe për të përdorur mekanizmat kushtetues për garantimin e tyre. Kjo gjithashtu minon besimin e qytetarëve tek shteti i së drejtës dhe administrata shtetërore ndërkohë që të gjitha përpjekjet në nivel evropian por edhe të Këshillit të Evropës janë të drejtuara për nga ruajtja e besimit të publikut dhe përmirësimi i këtij indikator.

<sup>5</sup> Organet e administratës publike janë të detyruara të bashkëpunojnë për të mbështetur organin publik që kryen hetimin administrativ në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes. Transparenca dhe llogaridhënia janë dy nga parimet kryesore të mirëqeverisjes në administratën publike. Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike sa i përket ushtrimit të veprimtarisë administrative nga ana e tyre.

përdorimin e fondeve, por vlerëson se institucionet zbatuese, në ushtrimin e veprimtarisë se tyre nuk e kanë zbatuar në mënyrë thelbësore këtë parim.

Lidhur me themelin e çështjes, vlerësojmë se IMT në ushtrimin e funksioneve të tij administrative ka cënuar të drejtat dhe interesat e ligjshme të qytetarëve duke mos zhvilluar një proces të rregullt ligjor. Ky konstatim bazohet në arsyetimin ligjor si më poshtë:

**Së pari.** Avokati i Popullit, referuar akteve dhe provave që janë administruar gjatë hetimit administrativ dhe të cilat i janë nënshtruar shqyrtimit administrativ, vlerëson se veprimtaria e IMT-së pranë Bashkisë Tiranë, nuk është ushtruar në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Ky institucion e ka kryer veprimtarinë tij administrative jo konform ligjeve dhe akteve nënligjore, duke mos respektuar procedurën administrative deri në veprimin përfundimtar për prishjen e ndërtimeve objekt shqyrtimi administrativ.

Kuadri rregullator në zbatim të të cilave kryejnë veprimtarinë këto inspektorate parashikojnë detyrimin për nxjerrjen e akteve administrative në respektim të procedurave ligjore.

Konkretisht IMT, është organ i administratës publike e ka detyrimin e zbatimit të rregullave të procedurës administrative sipas parashikimeve ligjore dhe në respektim të tyre duke patur në vëmendje parimet themelore të veprimtarisë administrative. Referuar sa më sipër konstatohet se, VKM nr.533, datë 22.09.2021 "Për shpronësimin për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit për zhvillimin e zonës së re, në përputhje me planin e detyruar vendor, përmes kompesimit me shkëmbim për të gjitha pasuritë që preken nga realizimi i projektit "Për zonën e re për zhvillim një njësinë administrative nr.4 dhe 8, zona "5 Maj", parashikon vetëm faktin e shpronësimit për interes publik në funksion të rindërtimit për zhvillimin e zonës së re si dhe listën e pronarëve apo posedueseve pasuritë e të cilëve preken nga ky shpronësim dhe masën e shpronësimit. Ndërsa veprimtaria, funksioni, kompetencat etj., të IMT-së nuk parashikohen në asnjë prej akteve ligjore e nënligjore të miratuara posaçërisht për këto raste si raste urgjente dhe specifike për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme që i ka shkaktuar. Ky organ në kryerjen e veprimtarisë së tij administrative zbaton rregullat e procedurat e parashikuara në ligjin e tij organik. Konkretisht, Ligji Nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme", është akti i cili parashikon në mënyrë

eksplicite përgjegjësitë dhe detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, në nenin 4 e 5<sup>6</sup> të tij .

Pra ky inspektorat në funksion të detyrës së tij primare për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit kryen jo vetëm prishjen e objekteve të kundraligjshme, por **vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit**

---

<sup>6</sup> Neni 4. Përgjegjësitë e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore. Pranë çdo njësie vendore ngrihet inspektorati i mbrojtjes së territorit, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, brenda territorit administrativ të kësaj njësie, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera. Inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i njësisë vendore përkatëse. Për përmbushjen e përgjegjësisë të parashikuara me ligj, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore mbështetet nga policia e njësisë vendore dhe pajiset me mjetet dhe makineritë e nevojshme nga njësia vendore.

Neni 5 Gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme: a) **vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit**; b) vendos gjoba, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit; c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të ndërtimit; ç) vendos pezullimin e punimeve/ndërtimeve në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit; d) vendos prishjen e ndërtimit të kundër-ligjshëm; dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi; e) detyrohet t'i japë informacionin dhe/ose dokumentacionin e kërkuar Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit brenda një afati kalendarik 5-ditor nga data marrjes së kërkesës, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij inspektorati; ë) merr vendim zhdëmtimi në ngarkim të subjektit kundërvajtës për shpenzimet e prishjes së ndërtimit dhe të kthimit të truallit në gjendjen e mëparshme; f) përgatit dhe i jep të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo tre muaj për masat e marra, sipas shkronjave “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, të këtij neni. Fjala “ndërtim/punim”, sipas këtij neni, përfshin ato procese dhe/ose objekte ndërtimore që ndërtohen ose instalohen në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, që zhvillohen nën dhe/ose mbi tokë, çdo veprim/proces ndërtimi, gërmimi, prishjeje, zgjerimi, riparimi, rinovimi, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në territor ose strukturë dhe i referohet gjendjes aktuale, vëllimit të punimeve të kryera, përfshirë dhe/ose rrethime të kundërligjshme në çastin e ushtrimit të inspektimit.

por sigurisht nën kompetencën dhe diskrecionin që i japin vetëm dispozitat procedurale të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Ndërkohë rezulton se VKM Nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, miratuar në zbatim të 9780/2007, në pikën 1/b të tij përcakton: ***“Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit pranë njësisë vendore: i) zbaton vendimet e marra nga organi i qeverisjes vendore në fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së territorit e disiplinimit të punimeve në ndërtim, brenda territorit nën juridiksionin e tij”***. Nga kjo VKM rezulton se në rast të planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes e disiplinimit të territorit apo të zonës së re në rastin konkret, **IMT zbaton vendimet e marra nga organet e qeverisjes vendore në fushën e zhvillimit.**

Kjo do thotë se IMT është një organ zbatues, ekzekutues i vendimeve të këtyre organeve dhe në kryerjen e kësaj veprimtarie, pra në lirin e territorit duhet të mbështetet në një akt të tillë. Është pikërisht vendimi përkatës i njësisë vendore ai që legjitimon këtë veprimtari dhe ku gjejnë pasqyrim edhe arsyet e ndërmarrjes së kësaj veprimtarie. Çdo veprimtari administrative duhet të mbështetet në një akt të dalë nga organi kompetent dhe brendave kompetencave të tij, i cili sigurisht gjen mbështetje tek dispozitat referuese. Duhet kuptuar që ligji dhe aktet nënligjore thjesht normojnë një fushë të caktuar të veprimtarisë të organeve shtetërore në mënyrë të përgjithshme e abstrakte duke vendosur rregulla të detyrueshme, por janë organet ato që me aktet e tyre administrative i konkretizojnë këto duke rregulluar veprimtarinë konkrete. Pa këto akte nuk mund dhe nuk duhet të funksionojë asnjë organ i administratës shtetërore pasi kjo do të sillte premisa për shkeljen e të drejtave të njeriut nga njëra anë por dhe parimeve themelore të së drejtës administrative nga ana tjetër.

Në një veprimtari administrative kaq të rëndësishme e cila në thelbin e saj çënon të drejtën e pronës dhe të drejtën e strehimit, e për rrjedhim të drejtën për një jetë të qetë familjare e një game të drejtash të tjera shumë të rëndësishme të njeriut, është absolutisht e papranueshme dhe aspak ligjore fakti që mungon një vendimarrje nga institucioni në favor të të cilit po kryhet kjo veprimtari. Në këtë kontekst ju drejtua IMT-së Bashkia Tiranë, për të na sqaruar se cili ishte dokumentacioni/akti administrativ ku ky organ ishte mbështetur dhe a kishte një vendim të organit të qeverisjes vendore në favor të të cilit po kryhej kjo veprimtari. Në përgjigje të sa mësipër i vetmi dokument ku IMT mbështetet dhe justifikon veprimtarinë e tij, është vetëm shkresa **nr.39032/1 prot., datë 07.10.2021 “Kërkesë për bashkëpunim”**, dërguar atij nga Drejtoria e Investimeve të Punëve Publike pranë Bashkisë Tiranë.

Duke qenë ky i vetmi dokument justifikues për IMT-në, lind nevoja e analizimit të elementëve thelbësorë të përmbajtjes së kësaj shkrese, natyrës së saj dhe sigurisht dhe fuqisë provuese.

Nga përmbajtja e tij rezulton të jetë kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, ndihmë dhe bashkëpunim për të vazhduar procesin e ndërtimit të objekteve sipas projekteve të miratuara dhe brenda afateve kontraktuale. Gjithashtu, kjo drejtori shprehet: *“Në kuadër të nisjes së procesit, po ju sjellim në vëmendje ecurinë e punimeve që objektet e mëposhtme të kenë prioritet në lirim sheshi me qëllimin për të përfunduar brenda afatit kalendarik disa prej tyre. Objektet janë si më poshtë:*

- *Ndërtimin e godinës nr.12 (Seksioni B) në zonën zhvillimore “5 Maji”;*
- *Ndërtimin e godinës nr.15 A (Seksioni 2) në zonën zhvillimore “5 Maji”;*
- *Ndërtimin e godinës nr.15 A (Seksioni 3) në zonën zhvillimore “5 Maji”;*
- *Ndërtimin e godinës nr.21 (Seksioni B) në zonën zhvillimore “5 Maji”;*
- *Ndërtimin e godinës nr.19 në zonën zhvillimore “5 Maji”.*

Ndërkohë, nuk rezulton të ketë asnjë dokumentacion tjetër shoqërues, si vendim i këtij organi apo kujtudo që legjitimohet për nxjerjen e akteve të kësaj natyre, dokumentacion hartografik apo të ndonjë lloji tjetër që provon faktin që IMT vërtet ka vepruar konform dispozitave ligjore duke zbtuar një vendim të pushtetit vendor. Do të duhej që IMT të verifikonte ndërmarrjen e kësaj veprimtarie pra për prishjen e objekteve nëpërmjet një akti administrativ vendimarrës dhe jo thjesht të mjaftohej me një kërkesë nga cilido organ. Detyrë e vetme e këtij institucioni nuk mund të jetë thjesht prishja e objekteve në mënyrë mekanike, absolutisht jo, ky është organ i administratës publike dhe duhet ta ushtrojë veprimtarinë e tij administrative duke respektuar normat procedurale dhe në themel të kësaj veprimtarie duhet të jetë kujdesi për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, sa më sipër parashikohet nga K.Pr. Administrative.

Çdo veprimtari e kundërt do të sillte cënimin e të drejtave kushtetuese, ligjore por sigurisht edhe të normave të së drejtës ndërkombëtare të cilat janë bërë pjesë e së drejtës së brendshme. Për të kuptuar më tej këtë veprimtari e për të sqaruar me kujdes çdo aspekt të së drejtës e çdo parashikimin ligjor për këtë rast, i cili mund të na çonte në një pretendim tjetër të IMT-së, për shembull se në këtë rast i është referuar edhe VKM-së nr.887/2019,

*“Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, i ndryshuar, vërejmë se në kapitullin IV të tij janë parashikuar procedurat e përshpejtuara për shqyrtimin dhe miratimin e lejes së zhvillimit dhe lejes së ndërtimit. Nga kjo VKM rezulton se në rastet e këtyre procedurave të veçanta nuk ka dy leje të veçanta si procedura standarde të planifikimit të territorit, leje ndërtimi dhe leje prishjes, por leja e ndërtimit duhet të përmbajë edhe lejen e prishjes së objektit. Në paragrafin e fundit të pikës 1 të këtij kapitulli, përcaktohet: *“Nëse prishja shoqërohet me ndërtim të ri, leja për prishje është pjesë e lejes së ndërtimit dhe shënohet në kushtet e dokumentit të lejes”*. Pra, edhe në rastin hipotetik të një procedure të përshpejtuar<sup>7</sup>, vendimi parashikon se është leja e ndërtimit ajo e cila duhet të ketë të shënuara kushtet për lejen e prishjes apo prishjen e objekteve. Çka do të thotë se leja e prishjes duhet të jetë e përfshirë në të, por jo të zëvendësohet nga leja e ndërtimit pasi vetë leja duhet të parashikojë kushtet e lejes së prishjes. Në rastin tonë objekt shqyrtimi administrativ, asnjë organ pavarësisht kërkesave të vazhdueshme përfshi dhe IMT nuk ka depozituar as leje prishje dhe as leje ndërtimi ku të përcaktoheshin kushtet e lejes së prishjes apo të dhëna të tjera që do të ligjëronin veprimtarinë e këtij organi të administratës publike. Në rastin kur në truallin objekt i shpronësimit nuk do të ndërtohet një objekt i ri, atëherë organi kompetent duhet të procedojë me një vendim për prishje i cili të përcaktojë edhe kushtet konkrete dhe të drejtat e ankimit.*

Për të zhvilluar një hetim ligjor të plotë e të gjithanshëm Avokati i Popullit hetoi më tej dhe ju referuar faqeve online të Bashkisë Tiranë, për të verifikuar nëse këto leje ishin publikuar nga kjo bashki sipas përcaktimeve ligjore, si dhe për të kuptuar në këtë rast se cilit akt i është referuar IMT. Nga verifikimi nuk u gjetën të publikuara as leja e zhvillimit dhe as ajo e ndërtimit dhe për pasojë as ajo e prishjes. Megjithatë, sikurse edhe u referua ky hetim ka për qëllim vetëm për të kuptuar nëse IMT është mbështetur në këto akte, pasi lidhur me veprimtarinë e bashkisë për këtë problematikë AP do të shprehet me një akt tjetër të veçantë ku dhe do të trajtohet më hollësisht. Në kontekst, në kushtet kur nuk kemi një dokument të tillë vlerësohet se IMT nuk ka zbatuar drejt ligjin dhe ka vepruar në kundërshtim me të.

---

<sup>7</sup> pasi nga dokumentacioni i përcjellë nga IMT nuk ka një pretendim të tillë

Sikurse u theksua më lart, i vetmi dokument i dorëzuar nga ky i fundit dhe mbi të cilin mbështet ligjërimi i veprimtarisë së tij, është thjesht kërkesa për bashkëpunim e sipërcituar dhe referuar VKM-së 533/2021, që nuk krijojnë asnjë detyrim për IMT-në. Duke analizuar më tej të gjithë komponentët e kësaj veprimtarie, evidentojmë faktin që gjatë korrespondencës së mbajtur me IMT-në, ju kërkua të na vihej në dispozicion dokumentacioni i mbajtur gjatë këtij procesi, si vendime prishje për çdo objekt nominalisht, akte konstatimi/proces-verbale konstatimi apo çdo dokument tjetër me të cilin është dokumentuar veprimtaria e IMT-së dhe ku është mbështetur proceduralisht ajo. Lidhur me këtë kërkim nuk kemi as përgjigje justifikuese apo sqaruese dhe as dokumentacion që të provojë që kjo veprimtari është dokumentuar apo të jenë marrë vendime prishje ku të bazohet ajo. Në kushtet kur nuk ka dokument provues, ky organ kishte detyrimin ligjor për të provuar faktet mbi të cilat e ka kryer këtë veprimtari, pasi mbi të bie barra e provës, por në kushtet kur nuk ka asnjë fakt të provuar vlerësojmë se nuk ka patur një proces të rregullt edhe në këtë veprim administrativ të IMT-së. Duket jashtë arsyes ligjore dhe logjike që të ndërmerret një veprim administrativ i cili, në thelb, të tij ka të bëjë me cenimin e të drejtave themelore të shtetasve dhe ai të mos dokumentohet. Theksojmë se çdo organ i administratës publike, përfshirë këtu edhe IMT, në çdo veprim administrativ të kyer duhet të marrë masat e nevojshme për dokumentimin e veprimit, në kuadër të transparencës me palët pjesëmarrëse në proces administrativ dhe të çdo të interesuari, si dhe në kuadër të llogaridhënies përkundrejt organeve kontrolluese. Gjithashtu, organi administrativ ka detyrimin të shprehet me një akt administrativ, mungesa e të cilit sjell cenimin e të drejtave të tjera si e drejta për njohje me veprimtarinë administrative, me ushtrimin e ankimit etj. Në raste të tjera analoge të trajtuara nga Avokati i Popullit, lidhur me veprimtarinë e IMT-së gjatë procesit të prishjes së objekteve është konstatuar se ky institucion ka marrë vendim në mënyrë nominale për çdo rast për prishjen e objekteve. Vetë legjislacioni ku mbështetet IMT parashikon nxjerrjen e vendimit të prishjes, si aktin i cili legjitimon ekzekutimin e kësaj veprimtarie administrative dhe ju jep të drejtë palëve të ushtrojnë të drejtën e ankimit. Kjo praktikë vërehet kryesisht në rastet kur konstatohen ndërtime të kundraligjshme, e cila përbën edhe bazën e veprimtarisë së IMT-së në mbrojtje të territorit.

Ndërsa, për këtë rast i cili shihet si rast *sui generis*, pasi nuk përbën misionin e këtij organi në vetvete por vepron në kuadër të bashkëpunimit dhe mbështetjes së organeve të tjera, IMT me shkresën nr.1713/1 prot., datë 22.02.2022 “Kthim përgjigje”, shprehet se “*nuk ka marrë vendim për prishjen e secilit objekt në mënyrë të veçantë pasi referuar pikës 2*

të VKM nr.533/2021 "Shpronësimi përmes kompensimit me shkëmbim bëhet në favor të Bashkisë Tiranë, për qëllim rindërtimi". Ky qëndrim është i pabazuar dhe aspakt ligjor e profesional, pasi cilido qoftë qëllimi i një procedure administrative, kjo nuk e justifikon organin kompetent për mosrespektimin e saj dhe anashkalimin e parashikimeve ligjore, që përbëjnë detyrimin themelor në ushtrimin e veprimtarisë administrative.

Vetëm për interes publik, kundrejt shpërblimit të drejtë dhe sipas procedurës së parashikuar shprehimisht në ligj. Mungesa e një procedure konkrete rregulluese e veprimtarisë së organit administrativ, nuk mund t legjitimoje ata, të mos dokumentojnë veprimtarinë e tyre, e kundërta është e vertetete, e rregullat e pergjithshme të Kodit të Procedures Administrative duhet të zbatohet në frymë dhe gërme. Nga ana tjetër, qartas marrja e vendimit, apo vijimi i prishjes së objekteve para se të garantohet shpërblimi apo para se të garantohen efektivisht lehtësirat që janë parashikuar nga ligji në fuqi, përbën cenim të së drejtës së pronësisë së qytetarëve si dhe të drejtën për të pasur një proces të rregullt ligjor.

Shohim me vend të kujtojmë këtu se edhe në rastet e tjera të prishjes së objekteve për zbatimin e projekteve për interes publik, sigurisht që shpronësimi paraprihet nga një vendim konkret i Këshillit të Ministrave, pasi kjo është një procedurë kushtetuese e ligjore e paderogueshme, IMT ka proceduar me vendime prishje. Përgjigja dhe justifikimi IMT-së se nuk ka proceduar me vendimarrje pasi rindërtimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë, për qëllim rindërtimi duket sa sipërfaqësor aq edhe kontradiktor në vetvete dhe konkretisht me garancitë kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve në lidhje me të drejtën e pronës. Kjo pasi çdo shpronësim për interes publik sigurisht që bëhet në favor të një organi shtetëror, i cili mbart detyrimet e tij ligjore e procedurale, por kjo nuk justifikon veprimet procedurale të asnjë organi tjetër administrativ. Aq më tepër që IMT nuk ka administruar vendime të këtij organi pasi pretendon se është mbështetur në veprimtarinë e tij tek shkresa për bashkëpunim dhe VKM nr.533/2021. Në rast se do të justifikonte veprimtarinë e tij tek VKM përkatëse dhe fakti që shpronësimi është bërë në favor të Bashkisë Tiranë, minimalisht duhet të kishte një vendim apo urdhër nga kjo bashki si organ epror. Bashkia Tiranë, si organ epror mbi të gjitha drejtoritë e tjera nuk rezulton të ketë nxjerrë ndonjë akt administrativ për këtë proces, por rezulton vetëm një kërkesë nga një drejtori tjetër, paralele me IMT-në, e cila kërkon bashkëpunim. Në këtë rast IMT duhet t'i kishte kërkuar dokumentacionin tekniko-ligjor ku mbështetej kjo veprimtari dhe pas marrjes së dokumentacionit duhet bërë një vlerësim i akteve nëse janë apo jo konform legjislacionit

në fuqi, pasi një akt i paligjshëm nuk duhet zbatuar edhe nëse do të ishte nga organi epror e aq më pak nga një drejtori paralele. Për sa më sipër rezulton qartë se veprimtaria e IMT nuk plotëson detyrimin kushtetues<sup>8</sup> sipas të cilit vetëm me ligj mund të parashikohet shpronësimi ose kufizimi i të drejtës së pronësisë. Sa më sipër do të thotë se vetëm mbi bazën e ligjit, dhe sipas procedurës së parashikuar në të, e cila duhet të garantojë legjitimitetin dhe perputhshmerinë me parashikimet kushtetuese, duhet të realizohet veprimtaria e organeve të administratës shtetërore në përgjithësi dhe IMT në rastin konkret.

Lidhur me sa më sipër parashtruam, edhe në rast se dispozitat e ligjit të posaçëm nuk parashikojnë rregullim të posaçëm për këtë çështje e këtë procedurë administrative, e cila sikurse pretendohet është e një lloji të veçantë dhe e miratuar në kushtet e një gjendje jo të zakonshme, atëherë organi kompetent ka mundësitë ligjore e duhet ti referohet përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative (K.Pr.A). Ky kod është akti bazë që ka për qëllim sigurimin e realizimit efektiv të funksioneve publike administrative në shërbim të personave, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre, në realizimin e këtyre funksioneve, duke zbatuar parimin e procesit të rregullt ligjor në mbrojtje dhe garantim të të drejtave të njeriut. Nuk mund të justifikohet mungesa e procesit të rregullt ligjor, si një prej parimeve bazë të shtetit të së drejtës, me faktin se qëllimi i veprimtarisë së ndërmarrë është e ndryshme nga ajo e realizuar zakonisht nga ky institucion. Cilido qoftë qëllimi për të cilën ndërmerret një veprimtari e caktuar administrative, ajo duhet të respektojë parimin e procesit të rregullt ligjor dhe parimet e tjera të rëndësishme të së drejtës të cilat qëndrojnë në themel të shtetit të së drejtës, duke respektuar çdo hallkë apo shkallë të procesit dhe aq më tepër vendimarrjen i cili është akti bazë ku mbështet veprimtaria dhe që justifikon atë. Vërtet IMT është organ ndihmës në kuadër të të gjithë kësaj veprimtarie administrative që ka për qëllimin zhvillimin e një zone të re, por ky nuk mund të jetë justifikim për anashkalimin e procesit të rregullt ligjor dhe parimin e ligjshmërisë. IMT ka detyrimin ligjor të kërkojë nga çdo organ tjetër “që ndihmon” dokumentacionin që ligjëron veprimtarinë si dhe të formalizojë kryerjen e çdo veprimtarie të tij me një akt të shkruar, i cili do ta ligjëronte atë. Në mungesë të një akti/vendimi veprimtaria do të konsiderohet e parregullt dhe e pabazuar ligjërisht. Të

---

<sup>8</sup> 1. E drejta e pronës private është e garantuar. 2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil. 3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë. 4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë. 5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.

drejtat dhe interesat e ligjshme të individëve, të pranuar dhe të sanksionuara në kushtetë, ligj apo akte nënligjore, në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt, pasi kjo do të cënonte thelbin e tyre.

**Së dyti.** Një moment tjetër që evidenton parregullsinë e këtij procesi të ndërmarrë nga IMT pranë Bashkisë Tiranë, ka të bëjë me mos njoftimin e rregullt të banorëve të kësaj zone në mënyrë nominale për prishjen e objekteve të tyre po ashtu edhe në verifikimin e faktit nëse ata janë njohur me vendimin, zbatimin e këtij projekti dhe shpronësimin e banesave të tyre për interes publik në një kohë të përshtatshme.

Për të verifikuar pretendimet e banorëve lidhur me këto shkelje, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështje, këtij organi administrativ i është kërkuar të provojë njoftimin për prishjen e objekteve për çdo subjekt në mënyrë të veçantë, efektshmërinë e tyre dhe në bazë të kësaj të provohej fakti që këtyre banorëve ju është lënë koha e nevojshme për gjetjen e një strehimi të përshtatshëm, mundësinë e marrjes së të gjitha sendeve të luajtshme nga objekti që do të prishet, si dhe koha e nevojshme për të ushtruar të drejtën e ankimit. Në përgjigje të të gjithë kërtimeve tona, me shkresën nr.1713/1 prot., datë 22.02.2022 “Kthim përgjigje”, IMT lidhur me këtë fakt shprehet se: *“Njoftimet janë kryer konform nenit 60 të K.Pr.Administrative, pika 1/b, personalisht nga specialistët e IMT Bashkia Tiranë, momenti i dorëzimit të njoftimit është shoqëruar gjithashtu me foto si dhe është bërë afishimi me shpallje pranë njësisë administrative. Njoftimet janë kryer brenda afateve të nevojshme për marrjen e masave të duhura”*. Ndërkohë bashkëlidhur shkresës nuk ka asnjë dokument që të provojë këto deklaramë dhe në mungesë të provave kanë vetëm vlerë deklarative të njëanshme. Edhe nga dokumentacioni i paraqitur me emailin e datës 20.05.2022 nga ana e Bashkisë Tiranë dhe IMT nuk rezultoi një situatë faktike e ndryshme. Nga dokumentacioni i paraqitur në rrugë elektronike rezultoi se në pjesën më të madhe të tij ai është përsëritje e atij të dërguar më parë nga Bashkia Tiranë dhe IMT, duke mos rezultuar fakte apo prova të reja, përveç shkresave nr.3620/1 prot., datë 09.11.2021 nga Njësia Administrative nr.4, shkresë datë nr.3672/1 prot., 15.11.2021 e njësisë Administrative nr.4 dhe shkresë nr.3388/1 prot., datë 12.11.2021 Njësia Administrative nr.8, të cilat kanë konfirmuar faktin se kanë realizuar afishimin e shpalljes për subjektet e kërkuara nga IMT plus disa fotografi të realizuara nga punonjësit e IMT gjatë komunikimit të vendimit për prishjen e banesave.

Në analizë të këtyre shkresave dhe pretendimit të IMT-së, kemi konsideruar me kujdes fuqinë provuese të tyre në raport me kërkesat e ligjit.

Fillimisht duhet evidentuar fakti se dispozita referuese nga IMT, pra neni 60 i K.Pr. Administrative, nuk parashikon asgjë lidhur me njoftimet por ka të parashikuar dispozitën me titull: *“Regjistrimi dhe vërtetimi i paraqitjes së kërkesës”*, nga përmbajtja e së cilës

përcaktohet: *“1. Marrja e kërkesës regjistrohet në organin publik ku paraqitet, sipas rendit kronologjik të paraqitjes në një regjistër të posaçëm. Regjistri i kërkesave për fillimin e procedurës administrative përmban informacionin e mëposhtëm: b) datën e dorëzimit;”*. Duket aspak korrekte dhe jo profesionale referimi në këtë dispozitë ligjore e cila i përket ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” i shfuqizuar tashmë me ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”. K.Pr.Administrative është akti bazë për funksionimin e organeve të administratës publike pas ligjeve organike të tyre dhe mosnjohja e tij për një periudhe kohe kaq të gjatë vë në dyshim mirëfunksionimin e vetë këtij insitucioni në thelbi e tij.

Aq më tepër kur mosnjohja e tij dhe referimi i gabuar cënon dhe vë në dyshim të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve të garantuara dhe mbrojtura nga dispozitat kushtetuese, normat ndërkombëtare të pranuar nga Shteti Shqiptar, si dhe aktet ligjore e nënligjore. Megjithatë shpresojmë që ky të jetë një gabim material pasi në të kundërt përgjegjësia institucionale është vërtet serioze dhe merr përmasa të tjera, sidomos kur kjo shkresë mban vulën dhe nënshkrimin e titullarit të institucionit. Por edhe në rast se supozojmë se kjo shkresë referon në dispozitat e Kodit të ri të Pr. Administrative, i miratuar me ligjin 44/2015, konstatohet se ky organ nuk ka respektuar normat procedurale me korrektësi duke zbatuar gabim ligjin. Së pari, analizojmë përgjigjen e IMT-së ku shprehet se *“Njoftimet janë kryer konform nenit 60 të K.Pr.Administrative, pika 1/b, personalisht nga specialistët e IMT, Bashkia Tiranë, momenti i dorëzimit të njoftimit është shoqëruar gjithashtu me foto”*. Pyetja që lind është se si e provon IMT faktin se njoftimet janë dorëzuar personalisht nga punonjësit e saj dhe fotografimin e tyre, dhe mbi të gjitha a përbën fotografimi një veprim procedural për njoftimin sipas K.Pr.A? Për të kuptuar drejt këtë i referohemi Kreut II të këtij kodi i cili parashikon mënyrat dhe mjetet e njoftimit. Neni 158 përcakton mënyrat e njoftimit duke parashikuar: *“Njoftimi formal bëhet nëpërmjet dorëzimit personalisht, njoftimit nëpërmjet të tretit apo postës, si dhe nëpërmjet publikimit elektronik, njoftimit publik apo botimit zyrtar, sipas parashikimeve të neneve 159 deri në 163 të këtij Kodi”*. Në rastin në shqyrtim organi përgjegjës ka zgjedhur njoftimin personalisht dhe me shpallje për disa subjekte. Për këtë mënyrë njoftimi do të flasim në vazhdim dhe tani do të fokusohemi tek *njoftimi personalisht*. Kjo mënyrë njoftimi është parashikuar nga neni 159, sipas të cilës: *“1. Nëpunësi i organit publik i dorëzon personalisht shkresën marrësit në një nga vendet e*

*njoftimit të parashikuara nga ky Kod*". Po ashtu, edhe neni 149 i kodit ka parashikuar si rregull njoftimin personalisht të personit përveç rasteve kur kodi parashikon shprehimisht ndryshe: *"Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Kod, njoftimi i bëhet palës personalisht. Përfshirë, kur organi publik është njoftuar për caktimin e një përfaqësuesi ose personit përgjegjës për njoftimet, njoftimi i bëhet këtij të fundit"*.

Përsa i përket vendeve të njoftimit që përmenden në nenin 159, i cili përcakton se njoftimi bëhet në vendet e parashikuara në kod, konstatohet se këto vende i ka specifikuar shprehimisht neni 151 i kodit duke mos lënë vend për pretendime të kundërta, ku sipas të cilit:

*"Njoftimi bëhet në:*

- a) vendbanimin ose vendqëndrimin e marrësit;*
- b) çdo vend, ku marrësi ndodhet, përfshirë dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;*
- c) selinë ose çdo vend ku ushtron veprimtarinë marrësi, nëse ky i fundit është person juridik;*
- ç) vendin e punës;*
- d) vendin e ushtrimit të veprimtarisë ose zyrën e marrësit;*
- dh) çdo vend tjetër, i specifikuar dhe i njoftuar paraprakisht nga pala"*.

Më tej, neni 159 parashikon se si procedohet pas dorëzimit të aktit të njoftimit dhe në raset kur personi nuk gjendet duke ezauruar çdo mundësi abuzimi me këtë të drejtë e detyrim njëkohësisht, sipas të cilit: *"Dorëzimi personalisht pasqyrohet në një procesverbal. Procesverbali përfshin të dhënat për identifikimin e shkresës së dorëzuar, datën e dorëzimit dhe nënshkruhet nga nëpunësi dhe marrësi. 2. Nëse marrësi nuk gjendet në vendin e njoftimit, nëpunësi i organit publik bën një përpjekje të dytë për dorëzimin personalisht, jo më parë se 24 orë dhe jo më vonë se 72 orë nga përpjekja e parë. 3. Kur marrësi nuk gjendet përsëri apo kur ai refuzon marrjen në dorëzim, nëpunësi bën shënimin përkatës në një procesverbal dhe kur është e mundur e vërteton situatën me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm. Në këtë rast, nëpunësi i organit publik vendos një shënim në mjediset e vendit të njoftimit, duke përcaktuar marrësin dhe zyrën përkatëse në organin publik ku mund të tërhiqet shkresa. Në shënim përcaktohet data dhe ora e lënies së shënimit dhe data që vlerësohet si data e kryerjes së njoftimit sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni. 4. Dorëzimi, sipas pikës 3, të këtij neni, vlerësohet i kryer pas 3 ditëve nga data e*

*vendosjes së shënimit. 5. Dorëzimi bëhet vetëm gjatë ditëve të punës, nga ora 7:00 deri në 19:00”.*

Nga kjo dispozitë rezulton se ligji kërkon mbajtjen e një procesverbali gjatë dorëzimit të aktit i cili të jetë i nënshkruar nga palët përkatëse. Në asnjë moment nuk parashikohet fotografimi si mënyrë njoftimi gjatë procedurës së njoftimit personalisht të palëve.

Kjo mënyrë njoftimi mbetet e paprovuar dhe për pasojë rezulton se qytetarëve ju janë prishur objektet, banesat e tyre pa pasur mundësinë e përgatitjes së ankimit, mbrojtjes së tyre në gjykatë si një prej të drejtave ekzistenciale në një shoqëri demokratike. Por ajo që e thellon akoma më tepër veprimtarinë administrative në kundërshtim me ligjin është edhe fakti se këtyre banorëve nuk ju janë garantuar as ju është lënë koha e mjaftueshme për të realizuar të drejtat më jetike të tyre, si e drejta për një strehim të përshtatshëm dhe me dinjitet për familjet e tyre, e drejta për jete të qetë private e familjare. Ndërsa përsa i përket njoftimeve të pretenduar se janë bërë me shpallje publike, me shkresën nr.44184 prot., date 08.11.2021 “Njoftim për shpallje”, rezulton se IMT i kërkon Njësisë Administrative nr.8 të behet shpallja publike e njoftimeve për 10 subjekte dhe përkatësisht: Vlash Mark Marku, Gjini Ndrec Nikolli, Geg Ndue Nikolli, Fehmi Xheladin Suti, Eduart Simon Nikolli, Bashkëpronarët Gjini (nuk janë identifikuar emrat e bashkëpronarëve), Simon Ndue Nikolli, Kujtim Miftar Cerri, Preg Pal Kodra dhe Arben Prend Deda, në korrespondencën e kryer me IMT prej saj nuk ishte paraqitur asnjë dokument në lidhje me këtë kërkesë, vetëm pas realizimit të takimit të Avokates së Popullit znj.Erinda Ballnaca si më sipër cituar, me Kryetarin e Bashkisë dhe zv.Kryetarin e Bashkisë Tiranë e pas një emaili shpjegues përmbledhës mbi gjithë kërkesat dhe kthim përgjigjet, bashkia na vë në dispozicion shkresën kthim përgjigje nr. 3388/1 prot datë 12.11.2021 të Njësisë Bashkiake nr. 8, nga përmbajtja e së cilës rezulton se kjo njësi ka afishuar njoftimet në këndin e shpalljeve për subjektet sipas kërkesës së IMT.

Ndërsa me kthim përgjigje nr. 3672/1 prot datë 15.11.2021 dhe nr. 3620/1 prot datë 09.11.2021 Njësia Bashkiake nr. 4, informon IMT se ka afishuar njoftimet në këndin e shpalljeve për subjektet sipas kërkesave respektive të saj datë 13.10.2021 me nr. 10261 prot. për shtetasit, Hilmi Metaj dhe Melita Ziza, dhe sipas kërkesës me nr. 44185 prot datë 08.11.2021 për shtetasit Din Ismailaj, Gentian Agaj, Bashkëpronarët Driza (pa emra), Agim Hanelli, Kujtim Cerri, Bashkëpronarët Ngota (pa emra), Atlum Ngota, Ivzi Hoxha,

Atli Hoxha, Lulzim Cami, Ervin Cani, Bashkëpronarët Feta(pa emra), Përparim Feta, Avni GJORANI, Ali Tola, Ilir Musabelliu, Sajmir Manallari, Vehbi Ilnica.

Sipas nenit 162 të K.Pr.Administrative shpallja pasohet nga një procedurë e pasqyruar rigorozisht, ku parashikohet:

*“2. Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijëni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet.*

*3. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni. Ky afat mund të zgjatet nga organi publik, për shkaqe të justifikuara. Data e shpalljes dhe heqjes së njoftimit përcaktohet në shkresën e vendosur në mjediset e përmendura në pikën 2 të këtij neni.*

*4. Përveç shpalljes së shkresës në mjediset e përmendura në pikën 2, të këtij neni, organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe gjithashtu mund ta botojë edhe në shtypin e shkruar, në dy gazetatat me tirazh më të madh.*

*5. Në rastin e njoftimit të një akti administrativ, teksti i shpallur përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 99<sup>9</sup>, të këtij Kodi, me përjashtim të pjesës arsyetuese. Ai shoqërohet me të dhëna për zyrën, vendin dhe mënyrën e njohjes me përmbajtjen e plotë të aktit administrativ”.*

Sa më sipër, konkludojmë se vetë njoftimi me shpallje publike përmban një sërë formalitetesh për vlefshmërinë e tij si dhe për tju garantuar qytetarëve të drejtat dhe interesat e ligjshme të tyre. Shkelja dhe mosrespektimi i procedurës së parashikuar nga ligji sjell paligjshmërinë e këtij veprimi administrativ, si dhe përgjegjësi institucionale dhe individuale për shkelësit e ligjit. jo që edhe më shqetësues është fakti se njoftimi publik me shpallje publike, është një mjet procedural përjashtimor dhe që mund të zbatohet vetëm

---

<sup>9</sup> Në çdo rast akti administrativ duhet të tregojë qëllimin e tij. 2. Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik përmban: a) pjesën hyrëse, që përmban: i) emrin e organit publik që nxjerr aktin; ii) palët të cilave u drejtohet akti; iii) datën e miratimit; iv) bazën ligjore; b) pjesën arsyetuese; c) dispozitivin që tregon: i) pjesën urdhëruese që tregon çfarë është vendosur; ii) kohën e hyrjes në fuqi të aktit; iii) të drejtën e ankimit, përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përlllogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit. 3. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga ligji, akti administrativ i shkruar në letër përmban nënshkrimin, emrin dhe mbiemrin e shkruar të nëpunësit përgjegjës, apo përkatësisht të kryetarit dhe të sekretarit të organit kolegjial. 4. Akti administrativ elektronik nënshkruhet në mënyrë elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto raste, kërkesat e pikës 3, të këtij neni, zëvendësohen me nënshkrimin elektronik të organit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

për raste të jashtëzakonshme dhe jo si një mënyrë e zakonshme njoftimi është zbatuar normalisht pa kaluar asnjë faze procedurale. Neni 162 i K.Pr.Administrative dhe jo neni 60 sipas referimit të IMT-ë, parashikon rastet se kur mund të procedohet me këtë mënyrë njoftimi dhe konkretisht:

*“1. Njoftimi publik bëhet në këto raste:*

- a) kur palët janë të panjohura;*
- b) kur vendi për njoftimin nuk është i njohur dhe njoftimi nuk është i mundur, sipas nenit 151 të këtij Kodi;*
- c) kur çdo formë tjetër njoftimi është e papërshtatshme apo e pamundur;*
- ç) në çdo rast tjetër të përcaktuar shprehimisht nga ligji”.*

Nuk ka asnjë dokument që të provojë përpjekjet e IMT-së për të ezauruar të gjitha mjetet e tjera procedurale të zakonshme për njoftimin e tyre. Në të kundërt në shkresën dërguar së bashku me dokumentat si më sipër cituar në rrugë elektronike me emalin e dates 20.05.2022 rezulton se IMT ne shkresën kthim përgjigje mbi informimin e të gjithë procedurës së ndjekur prej saj pretendon se njoftimet janë bërë direkt nga punonjësit e specialistët e IMT Bashkia Tiranë. IMT duhet të provonte që ky ishte opsioni i fundit për njoftim pasi ishin shteruar të gjitha mjetet e tjera efektive që parashikon K.Pr.Administrative. Sikurse u parashtrua, ky organ nuk ka depozituar dokumentacion që të provojë faktin se ky organ ka ezauruar të gjitha mënyrat e tjera të njoftimit të akteve apo veprimeve administrative, sipas parashikimeve të K.Pr. Administrative. Duhet të sqarohet se njoftimi publik është paraparë nga ligjvënësi si rast përjashtimor për njoftimet dhe mundësia e fundit në rast të ezaurimit të të gjitha mënyrave të tjera në mënyrë që edhe në raste përjashtimore të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve të mos vihen në dyshim e të mos krijohen premisa për cënimin e tyre. Parashikimet ligjore lidhur me njoftimin gjenden si të drejta kushtetuese e ligjore mungesa e të cilave cënon vetë thelbin e të drejtave të mbrojtura nga këto norma. Organi publik duhet të tregojë një kujdes të shtuar dhe të zbatojë me përpikmëri normat procedurale lidhur me njoftimet pasi parregullsia e tyre sjell shkeljen e një sërë të drejtash kushtetuese e ligjore duke e bërë të paligjshëm veprimin administrativ.

Çdo organ i administratës publike kur procedon me njoftimin e një akti apo veprimi administrativ të tij duhet të mbajë parasysh faktin dhe të kujdeset që njoftimi të jetë efektiv, t'i sigurojë mbrojtje ligjore palës, të jetë i kuptueshëm dhe i arsyetuar, të bëhet

duke pasur parasysh koston sa më të ulët për ta kryer. Konkretisht, K.Pr.Administrative, në nenin 147, të tij parashikon: *“1. Organi publik i komunikon palës ose një subjekti tjetër, të përfshirë në procedurën administrative, veprimin administrativ ose veprimin procedural me anë të njoftimit. 3. Në çdo rast, organi publik kryen njoftimin, duke pasur parasysh efektivitetin e tij, mbrojtjen ligjore të interesave të palës, transparencën dhe koston”.*

Në vijim të analizimit të veprimtarisë dhe pretendimeve të IMT-së, të shprehura me shkresën nr.1713/1 prot., datë 22.02.2022 “Kthim përgjigje”, konstatohet se me shkresën nr. 49917 prot., datë 15.12.2021 “Dërgim informacioni”, IMT, ka informuar Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Tiranë, me listën emërore të subjekteve që janë ekzekutuar, dmth të cilëve ju janë prishur objektet. Sipas kësaj shkrese janë ekzekutuar 36 objekte në total. Ndërsa me shkresën nr.1253 prot., date 03.02.2022 “Dërgim informacioni”, IMT informon përsëri këtë drejtori mbi listën emërore të subjekteve që janë ekzekutuar, dmth janë prishur. Sipas kësaj shkrese janë prishur 58. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se në pesë raste IMT e ka hartuar aktin e njoftimit për lirimin e sheshit të ndërtimit me datë 19.10.2021 dhe sipas përmbajtjes së këtij akti, edhe nëse do supozohej se njoftimet janë bërë rregullisht dhe në respektim të normave procedural, përsëri rezulton se afati për prishjen e objekteve është deri me datë 26.10.2021, pra koha në dispozicion vetëm 5 ditë. Edhe në rastin hipotetik që njoftimi është dërguar rregullisht, a mund të konsiderohet kjo kohë e mjaftueshme për lirimin e banesës, gjetjen e një strehimi të përshtatshëm apo ushtrimit të së drejtës së ankimit? Absolutisht jo, kjo qëndron jashtë çdo logjike ligjore dhe procedurale. Më tej në dy raste të tjera rezulton se akti i njoftimit është hartuar me datë 19.10.2021 nga IMT dhe ekzekutimi apo prishja e objekteve është kryer me datë 08.11.2021 edhe në këtë rast nuk ka asnjë dokument që të provojë dërgimin e tyre dhe marrjen dijeni realisht nga qytetarët. Po kështu vijojmë të sjellim disa shembuj të tjerë si; në gjashtë raste IMT ka hartuar shkresa/njoftimet me datë 19.10.202 dhe prishja e objektit është kryer me datë 01.11.2021 dhe nuk ka asnjë dokument për të vlerësuar marrjen efektivisht të njoftimit.

Në dy raste njoftimi është prodhuar me datë 11.10.2021, ndërkohë që ekzekutimi/prishja e objektit është kryer me datë 26.10.2021. Në gjashtë raste është njoftimet hartuar me datë 19.10.2021, ndërkohë që ekzekutimi/prishja e objektit është kryer me date 01.11.2021. Në shtatë raste të tjera njoftimet janë hartuar me datë 07.10.2021, ndërkohë që

ekzekutimi/prishja e objektit është kryer me datë 14.11.2021, e kështu me radhë. **Shprehemi se njoftimet janë hartuar nga ky organ dhe jo dërguar pasi nuk ka asnjë provë të dokumentuar apo fakt tjetër që të provojë se njoftimet janë dërguar dhe secili qytetar i ka marrë ato dhe është njohur me to në mënyrë nominale.** Në këto raste vlerësohet se njoftimet nuk janë dërguar dhe qytetarët nuk janë njohur me to, duke qenë se barra e provës bie mbi këtë organ të provojë njoftimet rregullisht dhe në zbatim të normave procedural. Për rrjedhojë shtetasve nuk ju është lënë një afat i arsyeshëm për marrjen e masave për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm, marrjen e sendeve nga objektet e tyre dhe mëtej nuk kanë pasur as afatin për të ushtruar të drejtën e ankimit si një e drejtë mjaft e rëndësishme në respektimin e çdo procedure ligjore administrative. Gjithë sa parashtruar më lart, të shpie në përfundimin se IMT ka kryer veprimtari të parregullt dhe të paligjshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij administrative. Shkelja e rregullave dhe procedurave të njoftimeve në vetevete përbën cënim të parimit të procesit të rregullt ligjor, si një prej parimeve që qëndron në themel të procedurave ligjore e administrative.

Pra, siç vërehet edhe në kryerjen e këtij veprimi administrativ IMT ka cënuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor e cila realizohet përmes njoftimit të rregullt dhe në zbatim të procedurave ligjore për njoftimin e veprimeve apo akteve administrative. Nga informacioni që disponojmë, konsiderojmë se procedura e njoftimit të banorëve të zonës së “5 Majit”, është kryer në kundërshtim me dispozitat ligjore procedurale të detyrueshme për njoftimin, si dhe nuk është treguar kujdesi i duhur për respektimin e të drejtave dhe interesave të ligjshme të banorëve të kësaj zone. Në asnjë rast nuk mundet dhe nuk duhet që organet e administratës pulike apo të pushtetit vendor në vendosin shtetasit në pozita të tilla ku koncepti kohë për marrjen e masave të jetë jashtë çdo llogjike dhe arsyeshmërie ligjore. Momenti i njoftimit ka lidhje me konceptin e hyrjes në fuqi të aktit dhe sjelljes së pasojave të tij, si dhe reflekton mundësinë kohore të subjektit me njohjen e përmbajtjes së tij si dhe reagimin fillestar për ndjekjen e rrugës së ankimit administrativ apo gjyqësor. Duke qenë se prishja e banesave/shtëpive është njoftuar dhe realizuar pa u bërë funksionale skema e përfitimit të bonuseve konkludojmë se IMT ka shkelur të drejtat e qytetarëve të njohuar nga Akti Normativ dhe ligji për shpronësimet.

Kjo mënyrë trajtimi, e cila realisht flet për veprimtari të kundraligjshme nga ana e IMT-së pranë Bashkisë Tiranë, konstaton faktin se banorëve të prekur nga kjo veprimtari ju

është përkeqësuar situata konkrete ligjore, duke iu shkelur në këto kushte të drejta të tilla si e drejta e pronësisë, e drejta e banesës, e drejta për një jetë të qetë familjare, e drejta e ankimit, ajo e aksesit në gjykatë e të tjera të drejta të rëndësishme të mbrojtura nga legjislati në fuqi. Cënimi i së drejtës së pronësisë është i lidhur ngushtë me të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe mungesa e këtij të fundit reflekton në cënim të kësaj të drejte. Cënimi i parimit të procesit të rregullt ligjor nga IMT Bashkia Tiranë, gjatë prishjes së objekteve në pronësi të këtyre banorëve ka sjellë në vetvete shkeljen e së drejtës së pronësisë si një e drejtë themelore. Sigurisht që e drejta e pronësisë nuk është një e drejtë absolute në kuptimin e saj, ajo mund të kufizohet por vetëm në kushtet e parashikuara nga kushtetuta, normat ndërkombëtare të pranuar nga Shteti Shqiptar, ligji, si dhe në zbatim të përpiktë të normave procedurale. Neni 41, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcakton shprehimisht se:

*“1. E drejta e pronës private është e garantuar.*

*2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.*

*3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë.*

*4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrajt një shpërblimi të drejtë.*

*5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.”*

Ndërkohë në pikën 1, të nenit 42, të Kushtetutës, përcaktohet: *“Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt ligjor”*. Kufizimi i së drejtës së pronësisë mund të ndodhë vetëm në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 17, të Kushtetutës ku përcaktohet se: *“1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut”*.

Pra, organet e administratës publike në kryerjen e veprimtarisë së tyre duhet të kujdesen që të respektojnë parimin e proporcionaliteti në mënyrë që të ruhet një ekuilibër mes të drejtave individuale, atyre shtetërore dhe publike. Duhet që absolutisht, asnjë organ

administrativ të mos cënojë të drejtat individuale në mënyrë disproporcionale nën petkun e asaj që quhet interes publik. Interesi publik në vetvete i shërben të drejtave dhe interesave individuale të secilit dhe cënimi i vetë këtyre interesave në mënyrë disproporcionale nuk do të kishte asnjë efektivitet, aq më tepër kur në rastin konkret bëhet fjalë për një numër jo të vogël familjesh të prekura nga kjo procedurë. E drejta e pronës si një prej të drejtave më të rëndësishme, është e parashikuar dhe sanksionuar edhe në nenin 1, të Protokollit 1, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. E drejta e shtetasve për shpronësim, parashikohet në këtë konventë, konkretisht Neni 1, i Protokollit 1 të saj ndër të tjera parashikon: *“Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”*. Në mjaft raste GJEDNJ ka theksuar faktin se të drejtat e pronësisë nuk janë absolute dhe të pakufizuara por nga ana tjetër këto kufizime duhet të bëhen në raport me parimin e proporcionalitetit. Në çështjen *Manastiret e Shenjta kundër Greqisë* (1994), kjo gjykatë mes të tjerave shprehet se: *“Kufizimi i të gëzuarit qetësisht të pasurisë duhet të vendosë një “raport të drejtë” ndërmjet kërkesave lidhur me interesat e përgjithshme të komunitetit dhe kërkesave lidhur me mbrojtjen e të drejtave themelore të individit..... Në mënyrë të veçantë, duhet të ekzistojë një lidhje e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve që përdoren dhe synimit që ndiqet për t’u realizuar me ndonjë masë që e privon një person nga e drejta e tij e pronësisë”*. Po kështu edhe në disa vendime të tjera si ai (*Bélané Nagy kundër Hungarisë*) i vitit 2016, GJEDNJ shprehet: Në thelb, kufizimet mbi të drejtën e pronësisë janë të përligjura nëse ato përmbushin tre kritere. Kufizimi duhet të jetë i ligjshëm, pra të parashikohet me ligj dhe të respektojë standardet e sundimit të ligjit; kufizimi duhet të ndjekë një interes publik ose të përgjithshëm si dhe duhet të jetë në përpjesëtim me synimin që ndiqet, i domosdoshëm në një shoqëri demokratike. Jo në pak raste, Shteti Shqiptar është dënuar për shkeljen e parimit për një proces të rregullt ligjor, ku objekt trajtimi ka qenë e drejta e pronësisë. Legjislacioni i brendshëm parashikon mënyrën e kufizimit të pronësisë, ku konkretisht neni 153 i Kodit Civil parashikon mënyrën e kufizimit të kësaj të drejte, sipas të cilit:

*“Askush nuk mund të shpronësohet ose t’i kufizohet e drejta e ushtrimit të së drejtës të pronës që barazohet me shpronësimin, përveçse kur këtë e kërkojnë interesa publike dhe kurdoherë kundrejt një shpërblimi të drejtë”, ndërsa Neni 192 i Kodit Civil “Sendet e paluajtshme dhe faktet që kanë lidhje me gjëndjen juridike të tyre regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Regjistrimi bëhet në bazë të një akti publik, të një vendimi gjykate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent, si dhe në rastet e tjera të*

*parashikuara nga ligji*". Pra kjo e drejtë gëzon mbrojtje kushtetuese e ligjore dhe çdo veprimtari në kundërshtim me këto norma sjell veprimtari antikushtetuese e ligjore. Përveç cënimit të së drejtës së pronësisë gjendemi edhe para shkeljeve të tjera thelbësore edhe të të drejtave të tjera të rëndësishme e jetike si e drejta e banesës, e drejta për një jetë të qetë familjare e private etj. IMT gjatë shembjes së banesave të subjekteve të shpronësuar për realizimin e projektit apo zhvillimin e zonës së re, si pjesë e së tërës së këtij procesi, përveç të tjerave kishte edhe detyrimin të verifikonte nëse këtyre shtetasve ju ishte mundësuar një strehim i përshtatshëm sipas përcaktimeve ligjore e nënligjore. Është e papranueshme, antikushtetuese dhe në kundërshtim me çdo normë ndërkombëtare e ligjore fakti që këtyre familjeve nuk ju është dhënë mundësia dhe koha e mjaftueshme për të siguruar një strehim të përshtatshëm. Është jashtë çdo logjike ligjore e njerëzore që IMT dhe çdo institucion tjetër i administratës publike, të cilët mbështeten për funksionimin e tyre tek paksapaguesit shqiptarë, të jenë shkelësit më të mëdhenj të të drejtave themelore të tyre. Ky institucion dhe çdo punonjës i tij duhet të jenë të kujdesshëm dhe të zbatojnë në mënyrë strikte normat ligjore e procedural, kur bëhet fjalë sidomos për të drejta të tilla themelore të cilat janë jetike për shëndetin dhe mirëqënien e këtyre familjeve. E drejta e banesës e sanksionuar si një prej të drejtave më të rëndësishme të njeriut ka qenë objekt i trajtimeve nga e drejta ndërkombëtare e veçanërisht nga GJEDNJ. Neni 8 KEDNJ parashikon të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, ku sipas këtij neni: *"1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve"*.

GJEDNJ në çështjen *Sharxhi kundër Shqipërisë* ka dënuar shtetin shqiptar për shkelje të të drejtave dhe mungesën e një procesi të rregullt ligjor gjatë ndërhyrjes së inspektorateve për prishjen e objektit. "Gjykata konstaton se ndërhyrja e policisë, e cila çoi në rrethimin e ndërtesës dhe në ndalimin e aplikantëve të kishin akses në shtëpitë e tyre dhe t'i përdornin ato, përbënte një ndërhyrje nga një autoritet publik ndaj së drejtës së tyre për respektimin e banesave të tyre. Në këtë mënyrë, ka pasur një shkelje të së drejtës së këtyre aplikantëve për respektimin e shtëpisë së tyre, sipas kuptimit të nenit 8, për shkak të konfiskimit dhe të rrethimit të godinës". Sipas rekomandimeve të OKB-së dhe nga interpretimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, shteti nëpërmjet organeve të tij ka detyrim të

menjëhershëm dhe të vazhdueshëm për të siguruar që të gjithë personat të kenë siguri në zotërim të banesës, pavarësisht disponimit ose të titullit të pronësisë. Me fjalë të tjera shteti duhet të garantojë mbrojtje ligjore kundër dëbimeve të detyruara, ngacmimeve, të ofrojë një bazë për realizimin progresiv të të gjitha aspekteve të së drejtës për sigurimin e banesës dhe një strehim të përshtatshëm. Ku siguria e banesës nuk përmbledhet në një nocion të vetëm, por ajo paraqitet në harmoni me të drejtat e tjera si drejta e pronësisë, e përdorimit, aksesit në gjykatë, procedurave të rishikimit administrativ e gjyqësor, etj. Për sa parashtruaq evidentohet qartësisht se IMT Bashkia Tiranë, në këtë procedure dhe formë sjellje të tij ka cënuar të drejtën e banesës dhe atë të jetës private rënditur si ndër të drejtat më të rëndësishme të njeriut.

- ❖ Në vijim të parashtrimit të shkeljeve dhe cënimit të të drejtave dhe parimeve themelore, konstatohet se një prej të drejtave më të rëndësishme të cënuara gjatë këtij procesi administrativ, sikurse edhe u parashtrua, është edhe e drejta e ankimit dhe ajo e aksesit në gjykatë. Këto të drejta janë cënuar në mënyrë sistematike në thelbin e tyre nga IMT, si rrjedhojë e mosrespektimit të normave materiale e procedurale. Mosrespektimi i normave procedurale gjatë procesit të njoftimit për prishjen e objekteve ka sjellë për pasojë mospasjen e kohës së mjaftueshme për tu ankuar ndaj vendimeve të tij dhe për tju drejtuar gjykatës kompetente. Koha efektive për përgatitjen e ankimit drejtuar gjykatës apo për përgatitjen e mbrojtjes nuk ka qenë e mjaftueshme, veçanërisht dhe në mënyrë flagrante në disa raste ku vërehet se nga koha e hartimit të njoftimeve deri në ekzekutimin apo prishjes e objekteve ka qenë vetëm pesë ditë. Ky afat kohor qëndron jashtë çdo logjike juridike apo arsyeshmërie ligjore. Kujtojmë këtu se Gjykata Kushtetuese në praktikën e saj por edhe normat ndërkombëtare e kanë përfshirë të drejtën për tju drejtuar gjykatës apo aksesin në gjykatë si pjesë të procesit të rregullt ligjor. KEDNJ e ka sanksionuar këtë të drejtë si një ndër të drejtat themelore të njeriut, duke parashikuar në neni 13 të saj se: *“Çdo person të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura nga kjo konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare edhe atëherë kur kjo shkelje është kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare”*. E drejta për ankim efektiv është një e drejtë themelore e njeriut dhe nënkupton të drejtën e individit për ankim, ekzistencën e një organi të caktuar për shqyrtimin e ankimit, pranimin e pakushtëzuar të ankimit për shqyrtim, afate të arsyeshme për shqyrtimin e tij. Në vetëvete ky nen sanksionon jo vetëm të drejtën e individit për t’u ankuar, por dhe detyrimin e shtetit për t’i garantuar atij këtë të drejtë. Në çështjen *Qufaj*

*kundër Shqipërisë*, ndër të tjera nga GJEDNJ theksohet se sistemi ligjor shqiptar ofron mjete juridike të brendshme, për të ankimuar një shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe këto mjete duhet të jenë efektive dhe të garantohen nga organet përkatëse. Në funksion të garantimit dhe mbrojtjes së këtyre të drejtave legjislativi shqiptar ka sanksionuar normat ligjore efektive. Konkretisht në rast se i referohemi pikërisht ligjit organik të mbi të cilin e mbështet veprimtarinë e tij IMT, konstatohet se ligji nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtime të kundërligjshme”, i ndryshuar, në nenin 14 të tij, përcaktohet: “*Kundër vendimit të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe atij të njësisë vendore lejohet ankimi i drejtëpërdrejtë në gjykatë brenda 10 ditëve, duke filluar nga data e njoftimit të vendimit*”. Kjo dispozitë shkon në të njëjtën logjikë me respektimin e së drejtës së ankuesit për tu ankuar dhe për tju drejtuar gjykatës. Madje në funksion edhe të arsytimit të paragrafëve të mësipërm, sanksionohet edhe fakti që ky institucion duhet të dalë me vendim për prishjen e objekteve dhe njoftimi duhet të jetë mjeti efektiv mbrojtës i të drejtave dhe interesave të ligjshme të individëve. Vetë legjislativi ka paraparë një afat prej 10 ditësh për tu njohur me aktin dhe për përgatitur mbrojtjen/ankimin, duke mos e konceptuar ushtrimin e një të drejte jashtë konceptit kohë e mjaftueshme.

- ❖ Nëse do të kthehemi Aktit Normativ dhe ligjit është e qartë se banorët do të trajtoheshin me bonus qiraje dhe afati i liritimit të banesës do të duhet të ketë dale me atë të marrjes efektive të bonusit të qirasë. Ndërkohë disa banesa rezultojnë të jenë prishur para daljes së miratimit të **Vendimit të Keshillit Bashkiak** për dhënien e bonusit, ndërsa nuk vërehet fare që **Bashkia** apo IMT të jenë kujdesuar që prishjet të jenë bërë pas miratimit të bonusit të qirasë.

Është e papranueshme dhe në kundërshtim me parimet themelore të së drejtës kryerja e veprimtarisë së organeve të administratës shtetërore në cënim të së drejtës dhe mundësisë efektive për të kundërshtuar paligjshmërinë e akteve nëpërmjet ankimit apo aksesit në gjykatë si pjesë të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. E drejta për një proces të rregullt ligjor është e lidhur ngushtë me të drejtën e njoftimit dhe atë të aksesit në gjykatë dhe të dyja këto përbëjnë dy prej komponentëve më të rëndësishëm të kësaj të drejte themelore. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj e ka konsideruar gjithashtu të drejtën e ankimit si të lidhur ngushtë me të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe cënimi i kësaj të drejte sjell në vetvete cënim të parimit për një proces të rregullt ligjor. Si përfundim, në logjikën dhe rregullimet përkatëse të legjislativitetit në fuqi evidentojmë

se gjithë procedura e ndjekur nga IMT, ka filluar dhe ka përfunduar në mënyrë të paregullt e të paligjshme, duke shkelur në mënyrë strukturore të drejtat dhe interesat e ligjshme të banorëve të prekur nga kjo procedurë administrative. IMT ka cënuar parimin më të rëndësishëm të së drejtës, atë procesit të rregullt ligjor i cili qëndron në themel të shtetit të së drejtës dhe që është indikator i rëndësishëm për matshmërinë dhe efektivitetin e këtij të fundit. IMT Bashkia Tiranë, duket se gjithë këtë veprimtari e ka justifikuar me mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave publikë, për zhvillimin e zonës së re për strehimin e banorëve të prekur nga tërmeti dhe kategoritë e tjera të parashikuara në ligj. Por shmangia nga kompetenca ligjore të organeve publike nuk mund të justifikohen me këtë arsytim në kushtet e një gjendje të zakonshme. Oranet e administrates shtetërore gjatë veprimtarisë së tyre duhet të ruajnë ekuilibrin ndërmjet të drejtave dhe interesave shtetërore apo publike dhe atyre individuale. Në asnjë rast nuk mund të cënohen të drejtat dhe interesat e qytetarëve pa respektuar parimin e proporcionalitetit ndërmjet këtyre të drejtave si dhe atë të procesit të rregullt. Shtetit shqiptar si subjekt i legjitimuar në Gjykatën e Strasburgut, kanë qenë ndër vite në epiqendër të kësaj gjykate, pikërisht për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ku më evidente ka qenë e drejta për një proces të rregullt ligjor. Shteti Shqiptar dhe taksapaguesit e tij mbajnë mbi supë detyrime dhe fatura financiare që vijnë si rezultat i vendimeve të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg, ku shteti shqiptar është dënuar për mosrespektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Tashmë institucionet shtetërore, qofshin këto qendrore apo vendore duhet të ishin njohur me këto vendime, të kishin reflektuar në gabimet e së shkuarës duke konsoliduar praktikën e tyre në mbrojtjen dhe respektimin e kësaj të drejte. Në këtë kontekst, shkelja e të drejtave themelore dhe veçanërisht ajo për një proces të rregullt ligjor mbart në vetvete dhe i ngarkon me një barrë të dyfishtë për shtetasit shqiptarë. Ku nga njëra qëndron cënimi i të drejtave dhe interesave individuale të shtetasve dhe nga ana tjetër përbën cënim të interesave dhe të drejtave publike, pra ato të taksapaguesve shqiptarë në tërësi.

Gjithë sa parashtrua më sipër, vlerësojmë të sjellim gjithashtu në vëmendje, parimin e përgjegjësisë në veprimtarinë e organeve publike të parashikuar në nenin 15, të Kodit të Procedurave Administrative, ku përcaktohet se: *“Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktajnë palëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi”*. Ndërsa neni 3/a i ligjit nr.8510, datë

15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”, i ndryshuar, përcakton: “*Organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet që u shkaktjnë personave fizikë a juridikë private, në rastet që vijnë: - Kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme*”. Në këtë këndvështrim, duam t’ju kujtojmë përkufizimin tashmë të pranuar nga Parlamenti Europian, në lidhje me keqadministrimin nga ana e organeve të administratës publike, sipas të cilit: “*Keqadministrimi ndodh kur një organ publik, nuk vepron në përputhje me një rregull apo princip, i cili është i detyrueshëm për të*”.

Sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në përputhje me nenin 18, Ligjit nr.8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”, i ndryshuar, si dhe nenit 22/1, Ligjit 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar ku përcaktohet se:

*“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit..., paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

## **REKOMANDOJMË**

1. *Marrjen e masave të menjëherëshme për të hartuar një rregullore/udhezim specifik në lidhje me veprimtarinë e IMT në rastet kur vepron në bazë të nenit 5 germa a të ligjit nr. 9780 date 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar e cila duhet të garantojë ndër të tjera kriteret e procesit të rregullt ligjor.*
2. *Marrjen e masave nga Bashkia Tiranë dhe IMT pranë kësaj bashkie, për nxjerjen e përgjegjësive dhe evidentimin e personave që kanë çuar në shkeljen strukturore të të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve të prekur nga prishja pa një proces të rregullt ligjor e objekteve në zonën e “5 Maji.*
3. *Fillimin e procedimit administrativ për shpërblimin e dëmit të shkaktuar këtyre shtetasve, si pasojë e ndërhyrjes dhe cënimit të ndërtimeve pa një proces të rregullt ligjor dhe pa respektuar dispozitat proceduriale në këtë rast.*

4. Marrjen e masave administrative për mospërsëritjen në vijim të situatave të tilla të ndërhyrjes ndaj objekteve private pa respektuar procedurat ligjore dhe të drejtat e shtetasve.
5. Marrjen e masave dhe nxjerrjen para përgjegjësisë administrative të personave përgjegjës që janë bërë pengesë për bashkëpunimin me institucionin e Avokatit të Popullit.

Në zbatim të nenit 22, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, lutemi të na vini në dijeni mbi qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi dhe masat e marra për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj,

**AVOKATI I POPULLIT**  
  
**ERINDA BALLANCA**  
SHQIPËRIE - TITULLI  
AVOKATI I POPULLIT